

REPUBLICA E KOSOVES-REPUB. E KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - V.LADA - GOVERNMENT
ZYRA E KRYE-MINISTRI-RED PREMJE-RA-OFFICE OF THE PRIME MINISTER
INSTITUTI I KRIMEVE TE KRYERA GJATE LUFTES NE KOSOVE

Dalëse

Nr. / Br. / No. **01/057**

Nr. i faq / Br. str / No. pg **3**

Data/Datum/Date **29.01.2026**

Pristinë - Priština - Pristina

UNIVERSITETI ISA BOLETINI MITROVICË
REKTORATI

Pranuar me dt. 29.01.2026			
Njesia orga	Num	Nr.Ekzem	Vlera
	210		



UNIVERSITETI /UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

NË MES TË

INSTITUTIT TË KRIMEVE TË KRYERA GJATË LUFTËS NË KOSOVË

DHE

UNIVERSITETIT "ISA BOLETINI", MITROVICË

Neni 1

Qëllimi

Ky Memorandum i Bashkëpunimit ka për qëllim përcaktimin e bashkëpunimit në mes të Institutit të Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë (në tekstin e mëtejshëm: Instituti) dhe Universitetit "Isa Boletini", Mitrovicë (në tekstin e mëtejshëm: Universiteti i Mitrovicës) në fushën e zhvillimit të projekteve hulumtuese, organizimit të konferencave, seminareve dhe aktiviteteve të tjera për ndarjen e burimeve dhe ekspertizës për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta me interes të ndërsjellë.

Neni 2

Synimi

Palët angazhohen për bashkëpunim të ndërsjellë, me synim dhe përmes aktiviteteve të përbashkëta do të ndihmojnë në procesin e ballafaqimit me të kaluarën, edukimin dhe angazhimin e studentëve në çështjet që lidhen me krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë.

Neni 3

Të drejtat dhe detyrimet e palëve

1. Palët do të bashkëpunojnë në një gamë të gjerë aktiviteteve dhe iniciativash me interes të ndërsjellë, duke ofruar ekspertizë dhe njohuri brenda fushave të tyre përkatëse të kompetencës, përfshirë, por pa u kufizuar në:
 - 1.1. Planifikimin dhe zbatimin e përbashkët të aktiviteteve në zhvillimin e programeve të ndryshme edukative që ndërlidhen me historinë, dokumentimi dhe pasojat e krimeve të luftës në Kosovë;
 - 1.2. Ndarja e burimeve dhe përvojave profesionale, përfshirë ekspertizën e stafit akademik dhe përfshirjen e studentëve, si dhe qasja në bibliotekat dhe arkivat e Institutit, për qëllime hulumtuese dhe projekte akademike;
 - 1.3. Organizimin e aktiviteteve edukative dhe shkencore, si konferenca, seminare tryeza të diskutimit dhe punëtori, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit mbi krimet e luftës dhe pasojat e tyre;
 - 1.4. Zhvillimin e iniciativave të përbashkëta për bashkëpunim ndërkombëtar, përfshirë kërkimin e partneriteteve me institucione dhe organizata rajonale e ndërkombëtare;
 - 1.5. Bashkëpunimi mbi parimet e përfitimit të ndërsjellë, ndihmës reciproke dhe veprimit të koordinuar për arritjen e qëllimeve të përbashkëta.
2. Iniciativat konkrete, modalitetet e zbatimit, burimet financiare dhe aspektet e tjera operative do të përcaktohen veçmas për secilin aktivitet apo projekt individual, përmes marrëveshjeve ose planeve të veçanta të dakorduara nga palët.

Neni 4

Kohëzgjatja

Ky Memorandum i Bashkëpunimit do të zgjasë katër (4) vite nga data e nënshkrimit nga palët nënshkruese. Memorandumi mund të vazhdohet me pëlqimin e palëve nënshkruese.

Neni 5

Ndërprerja

1. Ky Memorandum i Bashkëpunimit do të ndërpritet:

1.1 Me paralajmërim të arsyetuar me shkrim, së paku 30 ditë para datës së ndërprerjes së Memorandumit;

1.2. Me përfundimin e afatit kohor për të cilin është lidhur Memorandumi.

Neni 6

Ekzemplarët e Memorandumit

Ky Memorandum i Bashkëpunimit nënshkruhet në dy (2) ekzemplarë të njëjtë, nga një (1) ekzemplarë për secilën palë.

Neni 7


Hyrja në fuqi

Ky Memorandum i Bashkëpunimit hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga të dy palët.


Palët nënshkruese

Prof. Ass. Dr. Atdhe Hetemi

Prof. Dr. Nurten Beligradi Deva


Drejtor Ekzekutiv i IKKL-së


Rektore, Universiteti "ISA BOLETINI" Mitrovicë



Mitrovicë, më 29 janar 2026